



**TË RINJTË NË ZGJEDHJE:**



**ANALIZA PËR  
POZITËN E TË RINJVE NË  
ZGJEDHJET PARLAMENTARE  
TË VITIT 2024**





**TË RINJTË NË ZGJEDHJE:**

**ANALIZA**  
**për pozitën e të rinjve në**  
**zgjedhjet parlamentare**  
**të vitit 2024**

## TË RINJTË NË ZGJEDHJE:

Analiza për pozitën e të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024

### **Projekti:**

Praktiko demokraci

### **Botuesi:**

Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut [www.wfd.org](http://www.wfd.org)

### **Për botuesin:**

Dona Kosturanova, drejtore në vend për zyrën e Fondacionit për demokraci të Uestminsterit

### **Autore e analizës:**

Prof. d-r Marija Topuzovska Latkoviç

### **Redaktorë:**

Veton Zekolli, Dona Kosturanova

### **Redaktimi grafik:**

Brigada Dizajn

### **Përktheu:**

Jetmir Ziba

### **Vendi i lëshimit:**

Shkup

### **Viti i lëshimit:**

2024

# PËRMBAJTJA:

<b>PARATHËNIE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRË E SHKURTËR E LITERATURËS</b>	<b>5</b>
<b>KONTEKSTI NACIONAL</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b>	<b>12</b>
<b>ANALIZA E PËRFAQËSIMIT TË TË RINJVE NË LISTAT E KANDIDATËVE DHE NË PËRBËRJEN KUVENDORE</b>	<b>14</b>
<b>ANALIZA E PËRFAQËSIMIT TË ÇËSHTJEVE RINORE NË PROGRAMET ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE DHE PROGRAMIT TË QEVERISË</b>	<b>25</b>
<b>SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE</b>	<b>39</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>41</b>
<b>BIBLIOGRAFIA</b>	<b>43</b>

## PARATHËNIE

**P**jesëmarrja politike mund të shihet si një indikator i angazhimit demokratik, gjithëpërfshirjes dhe potencialit për ndryshime pozitive, megjithëse ndikohet nga faktorë kompleksë. Për fat të keq, hulumtimet tregojnë se të rinjtë në Maqedoninë e Veriut nuk janë aktivë në shoqëri (8 nga 10 të rinj e konsiderojnë veten joaktivë) dhe tre të katërtat nuk janë përfshirë ose konsultuar nga institucionet gjatë marrjes të vendimeve.

Atë që e konsiderojmë një sinjal pozitiv për demokracinë tonë është se 9 nga 10 të rinj gjithmonë ose ndonjëherë votojnë në zgjedhje. Gjithashtu, deri në 78% e të rinjve nuk e konsiderojnë politikën si punë vetëm të politikanëve.

Në një demokraci përfaqësuese, pjesëmarrja e grupeve të ndryshme të qytetarëve është e rëndësishme për të përfaqësuar perspektiva, përvoja dhe prioritete të ndryshme në vendimet e institucioneve. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme që të rinjtë të jenë pjesë e proceseve politike dhe të kenë rolin e tyre në to.<sup>1</sup>

Me këtë analizë shqyrtohet përfaqësimi i të rinjve në listat e kandidatëve në zgjedhje, si dhe politikën e dedikuara për të rinjtë në kuadër të programeve të partive politike në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024. Kjo është analiza e tretë e këtij lloji, pas atyre të mëparshmeve “Mungesa politike e të rinjve: Analizë për pozitën e të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020” dhe “Pjesëmarrja e shtyrë rinore: Analizë për pozitën e të rinjve në zgjedhjet lokale të vitit 2021”.

Me anë të kësaj analize sigurojmë të dhëna për atë se:

- ▲ A janë të rinjtë në listat e kandidatëve të partive politike dhe në cilat pozita?
- ▲ Sa janë të përfaqësuar politikën për të rinj në programet zgjedhore të subjekteve politike?
- ▲ Cilat janë politikën të cilat partitë politike parashikojnë për të rinjtë?

Ky hulumtim, analiza për kandidatët në zgjedhje bazohet në të dhënat nga platforma për shqyrtimin e listës së kandidatëve të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve<sup>2</sup>. Kjo platformë e zhvilluar në kuadër të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve, të realizuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES), që në më shumë cikle zgjedhore siguron transparencë të të dhënave të kandidatëve në zgjedhje dhe mundësi për analiza, për të cilat shprehim mirënjohje.

Meritat për përgatitjen e kësaj analize i ka autorja Marija Topuzovska Latkoviç. Mirënjohje për Jovana Gjorgjiovska dhe Martin Galevski të cilët, si pjesë e autorëve të analizave të mëparshme, ndanë përvojat dhe këshillat e tyre në hartimin e analizës.

Ne shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për Ambasadën Britanike në Shkup, pa mbështetjen dhe përkushtimin e së cilës për pjesëmarrjen rinore ky produkt nuk do të ishte i mundur.

Shpresojmë që ky punim të ofrojë informacione të dobishme në lidhje me përfaqësimin e të rinjve si kandidatë dhe politikën që propozojnë dhe përfaqësojnë partitë. Vetëm përmes pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politike, perspektivat, përvojat dhe problemet e tyre, ata mund të jenë pjesë e vendimeve dhe proceseve politike

Dona Kosturanova,

Drejtoreshë në vend për  
Fondacionin për demokraci të Uesminsterit  
Zyra në Maqedoninë e Veriut

1 Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut, Studimi 2023 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/fourth-study-socio-political-participation-youth-north-macedonia>

2 <https://candidatelist.sec.mk/>

## PASQYRË E SHKURTËR E LITERATURËS

Qëllimet hulumtuese të Studimit udhëhiqen nga supozimet dhe pritshmëritë që të rinjtë si anëtarë të parlamentit në një masë më të madhe dhe drejtpërdrejt do të jenë në gjendje të iniciojnë dhe përfaqësojnë politika për të rinjtë, si dhe të ndikojnë mbi ata.

Në të kaluarën, disa autorë<sup>3</sup> e kanë reduktuar pjesëmarrjen politike vetëm në një interes për të votuar. Një përkufizim më i saktë i nocionit është zhvilluar në vitet e mëvonshme dhe përfshin veprime ose aktivitete që synojnë të ndikojnë në politikën ose rezultatet politike<sup>4</sup>. Lidhur me pjesëmarrjen politike të të rinjve, literatura shkencore më së shpeshti e identifikon atë me pjesëmarrjen e përgjithshme politike, por tregon më pak interes të të rinjve për t'u angazhuar në procesin zgjedhor, krahasuar me grupmoshat e tjera, në krahasim me një interes më të madh për të marrë pjesë në forma jokonvencionale të aktivizmit politik<sup>5</sup>.

Është e nevojshme të kihet parasysh, se zakonisht moshja e demokracisë ka një ndikim kryesor në përfshirjen e të rinjve në politikë, pasi niveli i pjesëmarrjes politike është dukshëm më i ulët në demokracitë e sapokrijura në krahasim me demokracitë e përparura<sup>6</sup>.

Megjithatë, numri i madh i të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut që deklarohen si votues të rregullt (rreth 80%) është një lloj kurioziteti në krahasim me përqindjet e daljes së të rinjve në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të BE-së, ku një afinitet i tillë midis të rinjve është në rënie drastike<sup>7</sup>.

Në literaturën shkencore, ka debate që tregojnë një ndikim të caktuar të dallimeve të gjeneratave në punën e parlamentit. Kur bëhet fjalë për politikën, grupmosha të ndryshme mund të kenë qëndrime kontradiktore për çështjet e politikave që lidhen me prioritetet për buxhetim<sup>8</sup>, për shembull anëtarët e grupit të moshës së mesme mund të angazhohen për tatime më të ulëta, ndërsa anëtarët e grupit më të ri mund të angazhohen për shpenzime më të madh për arsim.

Është gjithashtu interesante të përmendet se në një zgjedhje, një kandidat me dy karakteristika që e bëjnë atë pjesë të grupit «të jashtëm» mund të tërheqë më shumë mbështetje të votuesve sesa një kandidat me vetëm një karakteristikë të tillë. Prandaj, propozimi i një kandidate që është e re dhe grua mund të jetë një përparësi, në vend të një pengese e dyfishtë<sup>9</sup>. Këto pritshmëri janë testuar në të dhënat për të gjithë anëtarët e Parlamentit evropian që nga viti 1979. Jo vetëm që është vërtetuar se prania e grave është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë historisë së parlamentit, por edhe se përfaqësimi i grave është vazhdimisht më i lartë në mesin e grupit të përfaqësuesve të rinj, më i ulët në mesin e përfaqësuesve të moshës së mesme dhe më i ulët në mesin e përfaqësuesve më të vjetër.

3 Lazarsfeld, P.F., Berelson, B., & Gaudet, H. (1968). *The people's choice: How the voter makes up his mind in a presidential campaign*. Columbia University Press.

4 Teorell, J., M. Torcal dhe J. R. Montero. 2007. "Political Participation: Mapping the Terrain." In *Citizenship and Involvement in European Democracies: A Comparative Analysis*, edited by J. W. van Deth, J. R. Montero, and A. Westholm, 334–357. New York: Routledge.

5 Bárta, O., Boldt, G., Lavizzari, A. (2021) Meaningful youth political participation in Europe: concepts, patterns and policy implications research study. Council of Europe and European Commission.

6 Kitanova, M. (2020). Youth political participation in the EU: evidence from a cross-national analysis. *Journal of Youth Studies*, 23(7), 819–836.

7 Galevski, M., Ivanović, I., & Jetković Janeva, J. (2022). Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Fluturim në vend. Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut, në dispozicion në [WFD Let vo mesto Socio politicko ucestvo na mladi ZA WEB.pdf](#)

8 Stockemer, D., Gallant, K., Lewis, S., Deom, J. C., & Lam, C. (2023). Youth's low presence in parliament: the perspective of candidates and elected representatives. *Politics, Groups, and Identities*, 1–21

9 Stockemer, D., & Sundström, A. (2019). Do young female candidates face double barriers or an outgroup advantage? The case of the European Parliament. *European Journal of Political Research*, 58(1), 373–384.

## KONTEKSTI NACIONAL

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore<sup>10</sup> rregullon pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike dhe aspekte të ndryshme të politikave rinore. Ligji mundëson që përmes kornizave ligjore dhe mekanizmave të mbështesës të rinjtë për të marrë pjesë në procesin demokratik dhe për t'u përfshirë në fusha të ndryshme të zhvillimit social dhe ekonomik. Sipas këtij ligji “të rinj” janë personat nga 15 deri në 29 vjeç.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë nga viti 2021, gjithsej 326.733 të rinj jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>11</sup> ose 17,8% e popullsisë së përgjithshme rezidente prej 1.836.713 banorësh

Përveç Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, është e rëndësishme të përmendet Strategjia nacionale për të rinj 2023–2027<sup>12</sup>, si një dokument strategjik që përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe avancimin e interesave të të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Strategjia nacionale për të rinj 2023–2027 mbulon tetë fusha kryesore tematike: 1. Pjesëmarrja rinore; 2. Informimi rinor; 3. Puna rinore; 4. Arsimi; 5. Kultura; 6. Shëndeti; 7. Sipërmarrja dhe mbështetja para punësimit dhe 8. Siguria (dhuna). Qëllimet e përcaktuara rezultojnë nga hulumtimi empirik i kryer mbi tendencat rinore<sup>13</sup> dhe takimet e grupeve të punës për secilën nga fushat. Agjencia për rini dhe sport është bartësi kryesor i procesit të hartimit të strategjisë. Procesi është i ngjashëm edhe me vitin 2016, kur u hartua Strategjia e mëparshme për të rinj<sup>14</sup> 2016–2023, në atë që ka dallime të caktuara në blloqet tematike<sup>15</sup> dhe në mënyrë përkatëse në treguesit për vlerësim dhe monitorim.

Republika e Maqedonisë së Veriut është vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që filloi zbatimin e masës së Garancisë për të rinj në vitin 2018, së pari si një projekt pilot në disa komuna, dhe që nga viti 2020 është zbatuar në të gjithë territorin, përmes Agjencisë së punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>16</sup>. Masa Garancia për të rinj lejon të rinjtë deri në moshën 29 vjeç, të cilët nuk janë të punësuar ose të përfshirë në arsim ose trajnim (NEET), të marrin një ofertë pune të përshtatshme, të vazhdojnë arsimimin e tyre ose të përfshihen në ndonjë nga programet dhe masat aktive të punësimit, për një periudhë prej 4 muajsh pas evidentimit të tyre si persona të papunë në Agjencinë e punësimit.

Në vitin 2022, është realizuar hartëzimi statistikor i personave të rinj NEET-ve<sup>17</sup>, për periudhën e viteve 2016–2021. Gjetjet në lidhje me gjasat që një person të bëhet NEET udhëzojnë në faktorë si gjinia, arsimi i përfunduar dhe lokacioni gjeografik si faktorë kryesorë. Në vitin 2022, përqindja e të rinjve NEET (të moshës 15–29 vjeç) ishte 22,8%<sup>18</sup>.

Ka njëfarë përparimi të caktuar me situatën në lidhje me papunësinë e të rinjve në vend, me çrast në vitin 2023 shkalla e papunësisë në mesin e popullsisë së re ishte 25,4%, me një shkallë të përgjithshme të papunësisë prej 13%<sup>19</sup>.

Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Republika e Maqedonisë së Veriut ndjek dhe analizon vazhdimisht pozicionin e të rinjve në kontekstin socio-ekonomik dhe politik të Maqedonisë së Veriut, shqyrton dhe mat qëndrimet dhe mendimet e tyre, në mënyrë që të identifikojë problemet dhe pengesat kryesore, por edhe mundësitë dhe perspektivat me të cilat përballen.

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/viti LXXVI (2020) Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, në dispozicion në [Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë \(slvesnik.com.mk\)](#)

11 Enti shtetëror i statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut [Popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas grup-moshave 5–vjeçare dhe sipas seksit, sipas komunave, Regjistrimi i popullsisë 2021. PxWeb \(stat.gov.mk\)](#)

12 STRATEGJIA NACIONALE PËR TË RINJ 2023–2027, në dispozicion në <https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2023/10/nsm23-27-sluzben-vesnik.pdf>

13 Agjencia për rini dhe sport e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2022) Anketa e trendeve rinore, në dispozicion në <https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2022/10/istrzhuvane-ams-2022.pdf>

14 STRATEGJIA NACIONALE PËR TË RINJ 2016–2023 NSMK.pdf (segaorg.mk)

15 Strategjia 2023–2027 prezantoi fushat tematike të sigurisë (dhunës) dhe sipërmarrjes, si dhe ndryshoi fushat e cilësisë së jetës dhe sportit nga Strategjia 2016–2023.

16 [Garancia rinore \(av.gov.mk\)](#)

17 ILO (2022) Të rinjtë që nuk janë të punësuar dhe nuk janë të përfshirë në arsim ose trajnim (NEET): Hartëzimi dhe këshillimi i politikave, i disponueshëm në [MKD NEET-Mapping-and-Policy-Proposals.pdf \(socijalendijalog.mk\)](#)

18 Stojceska, B., Dukovska, B., Topuzovska Latkovikj, M. et al (2023) Position of the NEET Youth in North Macedonia: Control study [Control-study- N.MACEDO-NIA.pdf - Google Drive](#)

19 [Raportet vjetore \(av.gov.mk\)](#)



Nga ana e Fondacionit për demokraci të Uestminsterit për herë të parë një studim mbi pozicionin e të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020<sup>20</sup>, i cili është një lloj studimi bazë (baseline) dhe një mundësi për analiza krahasuese në vazhdimin e tekstit, për shkak të përdorimit të një metodologjie të unifikuar hulumtuese.

Të dhënat nga studimet e mëparshme tregojnë një pakënaqësi në caktuar të të rinjtë, respektivisht “më shumë se një e treta e të rinjve janë plotësisht ose mjaftueshëm të kënaqur me vendin e tyre në shoqëri, ndërsa 6 nga 10 të rinj janë pjesërisht ose plotësisht të pakënaqur me vendin e tyre në shoqëri”<sup>21</sup>, dhe sipas të njëjtit studim “13% e të rinjve në vend mendojnë se institucionet kujdesen plotësisht ose mjaftueshëm për ta dhe problemet e tyre, ndërsa 8 nga 10 të rinj mendojnë se institucionet kujdesen pjesërisht ose aspak për ta dhe nevojat e tyre”.

Këto të dhëna bazohen në të dhënat e fundit nga Studimi për të rinj<sup>22</sup>, sipas të cilit në mënyrë kumulative 64,6% e të rinjve besojnë se interesat e të rinjve nuk janë të përfaqësuar në politikë (pjesa tjetër prej 25,9% përgjigjen se janë të përfaqësuar pjesërisht, 7,7% se janë të përfaqësuar mirë, dhe vetëm 1,8% se janë të përfaqësuar shumë mirë). Në të njëjtin hulumtim, të rinjtë e vlerësuan besimin e tyre në Kuvend me një vlerë mesatare të ulët  $m=2,26$ , në një shkallë nga 1 deri në 5.

Në Studimin për të rinj 2018/2019<sup>23</sup>, më shumë se gjysma ose 61% e të rinjve u përgjigjën se politikanëve nuk u intereson mendimi i tyre. Kur u pyetën nëse do të pranonin një funksion politik, shumica e të rinjve u përgjigjën me ndoshta (36,4%), ndërsa 12% u përgjigjën se do ta pranonin me kënaqësi një funksion të tillë. Megjithatë, kumulativisht 50% u përgjigjën negativisht.

Pjesëmarrja e dobët politike rinore është vërtetuar edhe nga studimet rajonale që matin Indeks të rinor për pjesëmarrjen<sup>24</sup> (politike ekonomike dhe sociale), sipas të cilit të rinjtë janë një nga grupet më pak të përfaqësuar në parlament ose, më konkretisht, përqindja e të rinjve (deri në moshën 29 vjeç) si anëtarë të parlamentit ishte 1,7% në vitin 2022, 1,6% në vitin 2021 dhe 3,3% në vitin 2020, pa një ministër të vetëm të ri (si dhe një zëvendësministër) në qeveri, në periudhën e monitorimit.

Është e rëndësishme të përmendet se në vitin 2017 u themelua Klubi për çështje dhe politika rinore në Kuvend, duke ndjekur shembullin e Parlamentit evropian dhe parlamenteve të tjera të Evropës perëndimore, të cilët vazhduan të punojnë dhe të zhvillohen në mandatin e ardhshëm të viteve 2020–2024, për shkak të numrit të madh të aktiviteteve. Klubi është një organ joformal, i përbërë nga deputetë të rinj të moshës deri në 35 vjeç dhe deputetë që kanë interes në çështjet dhe politikat rinore, anëtarë të të gjitha partive parlamentare, qëllimi i të cilëve është të arrijnë interesat e të rinjve në vend, në bashkëpunim me organizatat rinore, grupet rinore joformale dhe forumet rinore të partive politike. Qëllimi i Klubit është të kontribuojë dhe përfaqësojë çështjet dhe interesat e të rinjve në Kuvend.

20 Galevski, M., Gorgjiovska, J. (2020) MUNGESA POLITIKE RINORE: Analizë e pozitës së të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020. Botuesi: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut, në dispozicion në [Youth Political Absence - MK - web.pdf \(wfd.org\)](#)

21 Neziri, D., Kosturanova, D., Galevski, M. Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Fluturimi në vend (2021), Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut [WFD Le të vo mesto Socio politicko ucestvo na mladi ZA WEB.pdf](#)

22 Topuzovska Latkoviq, M., Borota Popovska, M., Naumovska, B., Starova, N. (2024) Studimi për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Fridrih Ebert – zyra në Shkup (në shtyp)

23 Topuzovska Latkoviq, M., Borota Popovska, M. Serafimovska, E., Cekic, A., Starova, N. (2019) Studimi për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Fridrih Ebert – Zyra në Shkup <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15292.pdf>

24 Sherifaj, E., Stojceska, B., Topuzovska Latkoviq, M., Dukovska, B., Gligorović, A., Vukadinović, K., Oy, B. (2023) YOUTH PARTICIPATION INDEX MONITORING REPORT OF POLITICAL, SOCIAL AND ECONOMIC PARTICIPATION OF YOUTH 2022. SERBIA, ALBANIA, MONTENEGRO, NORTH MACEDONIA, TURKEY. Publisher: Foundation Ana and Vlade Divac, Belgrade

## Zgjedhjet parlamentare 2024

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14 shkurt të vitit 2024 miratoi aktvendimin për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë, me datë të mbajtjes në 8 maj të vitit 2024. Listat e kandidatëve mund të dorëzohen më së voni deri në 2 prill (35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve). Fushata zgjedhore filloi më 18 prill dhe zgjati deri më 6 maj.

Terminologjia kryesore në lidhje me zgjedhjet parlamentare, e cila përdoret në hulumtim, në përputhje me përkufizimet e Kodit zgjedhor<sup>25</sup>:

- ▲ **“Parashtrues i listës”** janë partitë politike të regjistruara ose koalicionet e tyre të regjistruara në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, një grup zgjedhësish dhe deputetësh;
- ▲ **“Kandidat”** është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut i përcaktuar nga komisioni kompetent zgjedhor në përputhje me këtë Kod, për të cilin do të votohet në zgjedhje;
- ▲ **“Koalicion”** është bashkimi në bazë të marrëveshjes së dy ose më shumë partive politike të regjistruara për paraqitje të përbashkët gjatë kohës të mbajtjes së zgjedhjeve;
- ▲ **“Fushatë zgjedhore”** është prezantimi publik i kandidatëve të vërtetuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore për një lloj të caktuar zgjedhjesh;
- ▲ **“Procesi zgjedhor”** është koha nga miratimi i aktit për shpalljen e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të mbajtura, në nivel të komunës, Qytetit të Shkupit, respektivisht, njësisë zgjedhore ku mbahen zgjedhjet.

Sipas Kodit Zgjedhor, kandidat për deputet mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka aftësi për të vepruar, dhe nuk është dënuar me vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim pakusht me burg prej më shumë se gjashtë muajsh, ekzekutimi i të cilit nuk është iniciuar dhe nuk po vuan dënimin me burg për vepër penale të kryer.

Territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore (NJZ) të përcaktuara me këtë Kod dhe 20 deputetë zgjidhen në secilën njësi.

Pas shqyrtimit të listave të parashtruara të kandidatëve, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ) miratoi **aktvendime për listat<sup>26</sup> e hedhura poshtë të parashtruesve të listave për kandidatë për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024**, për këto subjekte politike dhe njësi zgjedhore:

- ▲ MAQEDONIA E VETME - për NJZ6
- ▲ Partia politike ALTERNATIVA E RE Shkup - për NJZ5 dhe NJZ6
- ▲ Partia politike e DJATHHTA - për NJZ5 dhe NJZ6
- ▲ PARTIA E PUNËS - për NJZ2, NJZ3, NJZ4 dhe NJZ6

Sipas të dhënave zyrtare të KSHZ-së, gjithsej n=17 subjekte politike (parti politike dhe koalicione) morën pjesë në zgjedhjet parlamentare.

Nga këto, 58,8% ose n=10 kishin lista të vërtetuara të kandidatëve në të gjashtë njësitë zgjedhore.

Numri më i madh i listave të kandidatëve (n=15) ishin në njësitë zgjedhore: NJZ1, NJZ3 dhe NJZ4. Numrin më të madh të kandidatëve (n=120) kishin këto nëntë subjekte politike: Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë, Koalicioni “FRONTI EVROPIAN”, Koalicioni “MAQEDONIA JOTE”, Koalicioni VLEN, KOALICIONI PËR ARDHMEN EVROPIANE, Koalicioni ME GUXIM për MAQEDONINË, Partia Politike DEMOKRATI Shkup, Partia politike E Majta (Levica), Partia Politike MAQEDONIA VENDLINDJA.

25 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, tekstet e pastruara të redaksisë (2024) KODI ZGJEDHOR, në dispozicion në [KODIN ZGJEDHOR - Teksti i pastruar \(Gazeta Zyrtare - Mars 2024\).pdf - Google Drive](#)

26 Njoftimi për aktvendimet për listat e vërtetuara dhe të hedhura poshtë të parashtruesve të listave të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 - Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (sek.mk)

Në tabelat e mëposhtme jepet një pasqyrë e detajuar e listave të konfirmuara të kandidatëve sipas subjekteve politike, numrit të kandidatëve dhe njësitë zgjedhore.

**Foto 1. Njësitë zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut - harta**




Tabela 1. Pasqyra e subjekteve politike që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 me përqindje dhe numër kandidatësh

Subjektet politike	Partitë dhe individët e përfshirë	% e numrit të përgjithshëm të kandidatëve	Numri i kandidatëve
AVAJA - MJAFT ËSHTË!		4.8	80
GRUPI I VOTUESVE GJYLA ÇELIKU		1.2	20
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë		7.2	120
MAQEDONIA E VETME		6	100
Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“	Bashkimi demokratik për integrim (BDI), PDSH, Partia demokratike evropiane dhe Lëvizja popullore.	7.2	120
Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“	VMRO-DPMNE (e përkthyer OBRM-PDUKM Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas), Partia Socialiste e Maqedonisë, Partia Demokratike e serbëve në Maqedoni - PDSM, Lidhja demokratike - LD, Veprimi Maqedonas - MAAK, Lëvizja e unitetit nacional të Turqve - LUNT, Partia progresive serbe në Maqedoni - PPSM, Partia popullore boshnjake - PPB, Forcat demokratike të romëve - FDR, Partia e demokratëve të bashkuar të Maqedonisë - PDBM, Partia e vllahëve nga Maqedonia, VOTË për Maqedoninë - VOTË, Partia liberale e re - PLR, Bashkimi socialdemokratik - BSD, Romët e bashkuar nga Maqedonia - RBM, Partia demokratike e Romëve - PDR, Partia bujqësore e punëtorëve të Republikës së Maqedonisë, Partia e bashkuar për barazi të romëve - PBBR, Dinjiteti, Bashkimi i përhershëm radikal maqedonas - BPRM, Partia të bashkuar për Maqedoninë - BM, Koncepti maqedonas - MKoncept.	7.2	120
Koalicioni VLEN	Lëvizja Besa, Alternativa, Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Demokratike	7.2	120
KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE	Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë-LSDM, Partia liberal demokratike - PLD, Partia e re socialdemokrate - PRSD, Partia popullore e VMRO-së - VMRO-PP, Partia për lëvizjen e turqve-PLT, Lidhja demokratike e vllahëve-LDV, Lidhja e Romëve nga Maqedonia, Partia e veprimit demokratik të Maqedonisë, Ripërtëritja demokratike e Maqedonisë-RDM, E djathta, Partia e Pensionistëve-PP, Partia për prosperitetin demokratik të romëve, Partia për përparim social dhe ekonomik - PPSE, Pala serbe në Maqedoni-PSM	7.2	120
Koalicioni GUXIMSHËM PËR MAQEDONINË	OPSIONI QYTETAR PËR MAQEDONINË - GROM, INTEGRA - PARTIA KONSERVATORE MAQEDONASE - INTEGRA, PARTIA PËR EMANCIPIM TË PLOTË TË ROMËVE NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT - PEPR nga RMV	7.2	120
Epoka e tretë maqedonase / Listat e pavarura maqedonase – Sovranët		7.1	119
Partia politike DEMOKRATI Shkup		7.2	120
Partia politike E DJATHTA		4.7	79
Partia politike E Majta		7.2	120
Partia politike ALTERNATIVA E RE Shkup		4.8	80
Partia politike MAQEDONIA VENDLINDJA		7.2	120
Partia e punës		2.4	40
PARTIA JOTE		4.7	79

**Tabela 2.** Shqyrtimi i listave të kandidatëve të parashtruar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2024

SUBJEKTET POLITIKE	NJZ1	NJZ2	NJZ3	NJZ4	NJZ5	NJZ6	Gjithsej
AVAJA - MJAFT ËSHTË!							4
GRUPI I ZGJEDHËSVE GJYLA ÇELIKU							1
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë							6
MAQEDONIA E VETME							5
Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“							6
Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“							6
Koalicioni VLEN							6
KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE							6
Koalicioni GUXIMSHËM PËR MAQEDONINË							6
Epoka e tretë maqedonase / Listat e pavarura maqedonase – Sovranët							6
Partia politike DEMOKRATI Shkup							6
Partia politike E DJATHTA							4
Partia politike E Majta							6
Partia politike ALTERNATIVA E RE Shkup							4
Partia politike MAQEDONIA VENDLINDJA							6
Partia e punës							2
PARTIA JOTE							4
Gjithsej	15	14	15	15	13	12	

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Studimi zbatoi një qasje të kombinuar hulumtuese duke përdorur metoda dhe teknika hulumtuese sasiore dhe cilësore, në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.

Studimi fillon me një pasqyrë të shkurtër të literaturës shkencore dhe profesionale mbi temën, si dhe një përshkrim të kontekstit nacional, duke analizuar të dhënat dytësore dhe duke analizuar përmbajtjen e dokumentacionit nacional.

Për pjesën e parë, **ANALIZA E PËRFAQËSIMIT TË TË RINJVE NË LISTAT E KANDIDATËVE DHE NË PËRBËRJEN PARLAMENTARE**, analiza është sasiore, ku njësi e analizës janë të rinjtë - si kandidatë në listat zgjedhore të subjekteve politike (partitë politike dhe koalicionet) në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pozicionimi i tyre në raport me kandidatët e tjerë dhe si pjesë e përbërjes së re parlamentare pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe menjëherë pas formimit të qeverisë së re. Përveç analizës bazë përshkuese për shqyrtimin, matjen dhe përshkrimin e përfaqësimit të përgjithshëm dhe pozicionimit të të rinjve, si një nën-popullsi specifike e popullsisë së përgjithshme kandidate, u zbatuan procedura të tjera të përshtatshme statistikore që analizuan dallimet sipas grupmoshës, gjinisë dhe karakteristikave të tjera, për të marrë një pasqyrë më të gjerë të gjendjeve

Për të përcaktuar popullsinë e re në studim, nisemi nga dy përkufizime. Përkufizimi i parë është marrë nga legjislacioni kombëtar, përkatësisht nga Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore,<sup>27</sup> sipas të cilit “të rinjtë” janë persona të moshës 15 deri në 29 vjeç, por, meqenëse është çështje e statusit specifik socio-politik dhe përcaktimit profesional (kandidat për deputet/deputet i Kuvendit)<sup>28</sup>, u miratua një përkufizim i dytë, sipas të cilit kufiri i sipërm për “rininë” relative të kandidatëve për deputetë është 39 vjeç. Prandaj, rezultatet në studim tregohen në aspektin e dy përkufizimeve të pranuar për të rinjtë (përmes grupmoshave: 18-29, 30-39 dhe kumulativisht 18-39).

Për mbledhjen e të dhënave për kandidatët në listat e votuesve të subjekteve politike në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 u përdor baza zyrtare e<sup>29</sup> të dhënave të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (KSHZ), me lista të vërtetuara të kandidatëve. Si afat i prerë (cut-off) në të cilin merret baza, mendohet dita e fillimit të fushatës zgjedhore më 18 prill të vitit 2024.

Për përshkrimin dhe analizën e përbërjeve parlamentare para dhe pas formimit të Qeverisë, listat zyrtare janë shkarkuar nga ueb-faqja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>30</sup>.

Të dhënat eksportohen më tej dhe (ri)kodohen në tre baza SPSS të veçanta të të dhënave, të cilat lejojnë llogaritje statistikore shitesë dhe të avancuara nga autori/konsulenti, si dhe grupimin e variablave me interes hulumtues (shpjeguar në tabelën në vazhdim).

Si kufizim i hulumtimit në pjesën sasiore të studimit, mund të thuhet se baza e të dhënave të KSHZ-së nuk përmban të dhëna për të dhëna të tjera socio-demografike për kandidatët, siç janë shkalla e arsimit, përkatësia etnike, statusi i punës, data e lindjes, etj.

Për më tepër, u bë një analizë sasiore krahasuese e përbërjeve parlamentare para dhe pas formimit të Qeverisë, për periudhat kohore: 2014–2016, 2016–2020, 2020–2024 dhe 2024–2028.

27 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/viti LXXVI (2020) Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore, në dispozicion në [Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë \(slvesnik.com.mk\)](http://GazetënZyrtare të Republikës së Maqedonisë (slvesnik.com.mk))

28 Sundström A, Stockemer D. Conceptualizing, Measuring, and Explaining Youths' Relative Absence in Legislatures. *PS: Political Science & Politics*. 2021;54(2):195–201. doi:10.1017/S1049096520000906

29 <https://candidatelist.sec.mk/CandidateList>

30 [Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - deputetët \(sobranie.mk\)](http://Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - deputetët (sobranie.mk))

Tabela 3 Variablat hulumtuese

Variabla	Burimi i të dhënave	Informacione shtesë
Mosha ekandidatëve	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Grupmosha të cilave u përkasin kandidatët	Të nxjerra nga autori, sipas të dhënave të KSHZ-së	Ndarja në grupmosha është bërë sipas dekadave: 18–29, 30–39, 40–49, 50–59, 60–69, 70–79 dhe mbi 80 vjeç.
Seksi i kandidatëve	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Komuna e vendbanimit sipas LNJ	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Njësia zgjedhore në të cilin ata po kandidojnë	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Subjekti politik që e kandidon	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Vendi në listën e kandidatëve	Të dhënat zyrtare të KSHZ-së	
Niveli i pozicionimit në listën e kandidatëve	Të nxjerra nga autori, sipas të dhënave të KSHZ-së	Kryhen katër nivele, secila me pesë vende radhazi të renditjes: 1–5, 6–10, 11–15 dhe 16–20.

Për pjesën e dytë, u krye **ANALIZË E PËRFAQËSIMIT TË ÇËSHTJEVE RINORE NË PROGRAMET ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE DHE PROGRAMIT QEVERITAR** për të analizuar përmbajtjen e programeve të subjekteve politike dhe programit qeveritar, me qëllim shqyrtimin në nivel cilësor nëse dhe si të rinjtë në vend mbulohen nga programet zgjedhore dhe për të përshkruar se për çfarë lloj politikash rinore angazhohen subjektet politike gjatë procesit zgjedhor.

Sipas Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore,<sup>31</sup> “politika rinore” është një grup masash dhe aktiviteteve të ndërmarra për të përmbushur nevojat e të rinjve, me qëllim arritjen e potencialit të tyre të plotë; ndërsa “pjesëmarrja e të rinjve” është një proces që u lejon të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin së bashku vendime në lidhje me politikën dhe programet që drejtpërdrejt ose tërthorazi formësojnë jetën e të rinjve.

Programet zgjedhore u shkarkuan në formatin word ose pdf, nga ueb-faqet e subjekteve politike, përmes platformës online ‘Qeveria e përgjegjshme’<sup>32</sup>, si dhe duke paraqitur një kërkesë në adresat oficiale të postës elektronike ose mediat publike online të subjekteve politike.

Megjithëse qëllimi fillestar dhe kryesor i Studimit ishte të analizonte programet zgjedhore të të gjitha (n=17) subjekteve politike që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare, n=8 programe ende ishin shpallur publikisht dhe/ose ishin në dispozicion.

Kjo situatë paraqet një kufizim të rëndësishëm hulumtues, por edhe një implikim të rëndësishëm hulumtues për qëndrimin dhe marrëdhënien e subjekteve politike ndaj programeve të tyre zgjedhore, si dokumente kryesore në fushatën zgjedhore dhe procesin zgjedhor në tërësi, të cilat pritet të komunikojnë planet, angazhimet dhe vizionet themelore për qytetarët, si dhe të ndikojnë në tërheqjen e votuesve të mundshëm dhe mbajtjen e mbështetësve të lidhur me partinë politike dhe ndjekësve të partisë politike.

Procesi i analizës së përmbajtjes përbëhej nga disa hapa. Për kërkimin në dokumente, u përdorën fjalët kyçe të mëposhtme në programet zgjedhore: të rinjtë (me variacionin: të rinjtë); rinore (me variacionet: rinore, rinoret, rinorja); studentët (me variacionin: studentët); studentore (me variacionet: studentore, studentit, studenteve). Më pas është analizuar konteksti në të cilin u përdorën fjalët kyçe të zbuluara me qëllim identifikimin e fushave kryesore të politikave dhe masave të parashikuara për të rinjtë, për secilin nga programet. Megjithëse u përdor analiza cilësore për këtë pjesë, disa nga të dhënat u kuantifikuan ende, me qëllim që të prioritetizoheshin dhe/ose kategorizoheshin gjetjet e caktuara të hulumtimit, si dhe të sigurohej një paanshmëri më e madhe në interpretimin e rezultateve.

Për shkak të formatit të ndryshëm të dokumenteve dhe specifikave të gjuhës maqedonase dhe mbështetjes cirilike në Microsoft Office, nuk u përdor asnjë softuer për analizë cilësore.

Për një ilustrim më të detajuar të njohurive të caktuara të hulumtimit, në tekst paraqiten fragmente nga programet zgjedhore, në formën e citimeve. Të dhëna të caktuara paraqiten në formë tabelare ose piktoreske, me interpretim tekstual.

31 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr. 10/20) Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore, në dispozicion në [Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë \(slvesnik.com.mk\)](#)

32 [Qeveria e përgjegjshme \(odgovornavlada.mk\)](#)


# ANALIZA E PËRFAQËSIMIT TË TË RINJVE NË LISTAT E KANDIDATËVE DHE NË PËRBËRJETEN KUVENDORE

## Përshkrimi i mostrës së kandidatëve për deputetë

Sipas listave të konfirmuara të KSHZ-së, gjithsej  $n=1677$  kandidatë të vërtetuar morën pjesë në zgjedhje, përfaqësues të gjithsej 17 subjekteve politike (parti politike dhe koalicione), të shpërndara në gjashtë njësi zgjedhore. **Mosha mesatare e të gjithë kandidatëve është  $m=46,52$  vjeç** (SD= $\pm 14,99$  në kategorinë e moshës nga 18 deri në 90 vjeç). **Sipas gjinisë, 57,2% ( $n=960$ ) e kandidatëve janë të gjinisë mashkullore dhe 42,8% ( $n=717$ ) janë të gjinisë femërore.** Mosha mesatare e burrave-kandidatë për deputetë është  $m=47,21$  vjet (SD= $\pm 14,66$  në intervalin e moshës prej 18 deri në 90 vjet), ndërsa mosha mesatare e grave-kandidate për deputete është  $m=45,59$  (SD= $\pm 15,38$  në intervalin e moshës prej 18 deri në 90 vjet).

**Kandidatët e rinj (18–29 vjeç) përbëjnë 14,6% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve. Kategoria e zgjeruar e moshës së kandidatëve të rinj për deputetë (18–39) në mënyrë kumulative arrin në 35,5%.** Ka pasur një rënie të dukshme të përfaqësimit të kandidatëve të rinj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, me përqindje që ishin përkatësisht 19,17% dhe 44,94%, për grupmoshat 18–29 dhe 18–39 vjeç<sup>33</sup>. Nga grafiku mund të vërehet se përqindja më e madhe e kandidatëve për deputetë përmban kategorinë e moshës 40–49 vjeç me 22,50%, dhe më pas grupmoshat 30–39 dhe 50–59 vjeç, të cilat kanë një përqindje identike prej 20,9%.


Grafiku 1. Shpërndarja e përqindjes së kandidatëve për deputetë sipas grupmoshës




Kontrolli i shpërndarjes së kandidatëve sipas gjinisë dhe grupmoshës, tregon se **kandidatët për deputetë meshkuj janë dominues në të gjitha grupmoshat - përveç në grupmoshën më të re (18–29 vjeç)**, ku numri i kandidateve femra është  $n=125$ , kundrejt  $n=120$  kandidatëve meshkuj. Kjo gjetje përsëritet si në analizën e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020.

33 Gjorgjiovska, J., & Galevski, M. (2021). Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Pabarazia, pasiguria dhe pritjet e ndryshme. Fondacioni për demokracitë të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut, në dispozicion në [Socio-Politicko Ucestvo na mladite 2021 MK \[smlweb\] \(1\).pdf \(wfd.org\)](#)



**Grafiku 2. Krahasimi seksual i shpërndarjes së kandidatëve sipas grupmoshës (n)**

Lidhur me shpërndarjen gjinore të kandidatëve në njësitë zgjedhore, mund të konstatohet se **në të gjashtë njësitë zgjedhore numri i burrave - kandidatë për deputetë është dukshëm më i lartë se numri i grave - kandidate**. Ka më shumë kandidate në njësinë e tretë zgjedhore (n=126) dhe menjëherë pas kësaj me numra identikë (n=125), në njësinë e parë dhe të katërt zgjedhore. Nga ana tjetër, ka më pak kandidate për deputete në njësinë e gjashtë zgjedhore (n=110).

**Grafiku 3. Shpërndarja seksuale e kandidatëve për deputetë sipas njësite zgjedhore (n)**

Analiza e subjekteve politike, sipas grupmoshave të cilave u përkasin kandidatët nga listat e tyre, tregon se në mënyrë domethënëse më shumë kandidatë të rinj ka **AVAJA- MJAFT ËSHTË!** (43,8% nga 18-29 dhe 27,5% nga 30-39, kumulativisht 71,3%), në vend të dytë Koalicioni **VLEN** (25,8% nga 18-29 dhe 33,3% nga 30-39, kumulativisht 59,1%), në vend të tretë është Koalicioni «**FRONTI EVROPIAN**» (20,8% nga 18-29 dhe 35,8% nga 30-39, kumulativisht 56,6%) dhe **KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE** (25% nga 18-29 dhe 26,7% nga 30-39, kumulativisht 51,7%), vendi i katërt është partia politike **E Majta** (16,7% nga 18-29 dhe 33,3% nga 30-39, kumulativisht 50%).

Të gjitha subjektet e tjera politike (n=12) kanë më pak se 50% të rinj (18-39) në listat e kandidatëve, dhe përqindja më e ulët e kandidatëve të rinj ka **MAQEDONIE E VETME** (2% e 18-29 dhe 5% e 30-39, kumulativisht 7%) dhe një **Parti e punës** (2,5% e 18-29 dhe 5% nga 30-39, kumulativisht 7,5%).

PARTIA JOTE ka gjithashtu 2,5% të rinj nga grupmosha 18–29 vjeç, por edhe 15,2% që i përkasin grupmoshës 30–39 vjeç, respektivisht kumulativisht 17,7%.

Të dhënat e detajuara për të gjitha subjektet politike janë paraqitur në mënyrë të veçantë në tabelën në vazhdim

**Tabela 4.** Pasqyra e shpërndarjes së kandidatëve për deputetë sipas grupmoshave për secilin subjekt politik

Subjekti politik	18–29	30–39	40–49	50–59	60–69	70–79	mbi 80
AVAJA - MJAFT ËSHTË!	35 (43.8%)	22 (27.5%)	17 (21.2%)	2 (2.5%)	4 (5%)	0	0
GRUPI I VOTUESVE GJYLA ÇELIKU	4 (20%)	2 (10%)	5 (25%)	7 (35%)	2 (10%)	0	0
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë	14 (11.7%)	36 (30%)	28 (23.3%)	32 (26.7%)	10 (8.3%)	0	0
MAQEDONIA E VETME	2 (2%)	5 (5%)	6 (6%)	27 (27%)	33 (33%)	22 (22%)	5 (5%)
Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“	25 (20.8%)	43 (35.8%)	30 (25%)	17 (14.2%)	5 (4.2%)	0	0
Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“	12 (10%)	31 (25.8%)	49 (40.8%)	21 (17.5%)	6 (5%)	1 (0.8%)	0
Koalicioni VLEN	31 (25.8%)	40 (33.3%)	32 (26.7%)	14 (11.7%)	3 (2.5%)	0	0
KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE	30 (25%)	32 (26.7%)	32 (26.7%)	22 (18.3%)	3 (2.5%)	1 (0.8%)	0
Koalicioni GUXIMSHËM PËR MAQEDONINË	14 (11.7%)	15 (12.5%)	26 (21.7%)	35 (29.2%)	25 (20.8%)	4 (3.3%)	1 (0.8%)
Epoka e tretë maqedonase / Listat e pavarura maqedonase – Sovranët	9 (7.6%)	14 (11.8%)	27 (22.7%)	39 (32.8%)	22 (18.5%)	4 (3.4%)	4 (3.4%)
Partia politike DEMOKRATI Shkup	16 (13.3%)	9 (7.5%)	16 (13.3%)	28 (23.3%)	34 (28.3%)	16 (13.3%)	1 (0.8%)
Partia politike E DJATHTA	6 (7.6%)	5 (6.3%)	12 (15.2%)	28 (35.4%)	19 (24.1%)	8 (10.1%)	1 (1.3%)
Partia politike E Majta	20 (16.7%)	40 (33.3%)	40 (33.3%)	19 (15.8%)	1 (0.8%)	0	0
Partia politike ALTERNATIVA E RE Shkup	10 (12.5%)	18 (22.5%)	21 (26.2%)	7 (8.8%)	11 (13.8%)	12 (15%)	1 (1.2%)
PARTIA POLITIKE MAQEDONIA VENDLINDJA	14 (11.7%)	25 (20.8%)	22 (18.3%)	20 (16.7%)	24 (20%)	12 (10%)	3 (2.5%)
Partia e punës	1 (2.5%)	2 (5%)	4 (10%)	12 (30%)	6 (15%)	14 (35%)	1 (2.5%)
PARTIA JOTE	2 (2.5%)	12 (15.2%)	10 (12.7%)	21 (26.6%)	29 (36.7%)	4 (5.1%)	1 (1.3%)

**Sa i përket përfaqësimit gjinor të kandidatëve, përshtypja e përgjithshme është se ka më shumë burra - kandidatë për deputetë sesa gra-kandidate në të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhjet parlamentare.**


**Përqindja më e madhe e grave kandidate për deputete ka KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE (49,2%) ose pothuajse gjysma e numrit të përgjithshëm të kandidatëve.**

Katër nga 17 subjekte politike (AVAJA - MJAFTË ËSHTË; Koalicioni «FRONTI EVROPIAN»; Partia politike DEMOKRATI Shkup dhe Partia politike Levica) propozuan saktësisht 40% kandidate, duke përbushur kështu kuotën minimale gjinore të përcaktuar me Kodin zgjedhor.

Partia politike E DJATHHTA pas vërtetimit të listave ka 35,4% kandidate gra, respektivisht më pak se kuota minimale gjinore.

Përqindja e grave kandidate në subjektet tjera politike varion nga 41% në 45%.

**Grafiku 4 Shpërndarja seksuale e kandidatëve për secilin subjekt politik (n)**



## Marrëdhënia midis variablave bazë demografike dhe vendit rendor të listave të kandidatëve

Një korrelacion negativ i dobët, por statistikiisht i rëndësishëm u regjistrua midis variablave 'mosha' dhe 'vendi rendor' në një listë kandidatësh ( $r=-0,068$ ;  $p<0,01$ ). Kjo do të thotë se ndërsa një variablë rritet, tjetra zvogëlohet pak. Kështu, kandidatët më të vjetër rënditen më lart në lista dhe anasjelltas, kandidatët më të ri rënditen më poshtë.

Grafiku 5. Matrica e korrelacionit


		Numri rendor i listës	Mosha
Numri rendor i listës	Korrelacioni i Pirsonit	1	-.068**
	Rëndësia (e dyanshme)		.006
	N	1677	1677
Mosha	Korrelacioni i Pirsonit	-.068**	1
	Rëndësia (e dyanshme)	.006	
	N	1677	1677

\*\* Korrelacioni është domethënës në nivelin 0.01 (i dyanshëm)..

**Niveli i parë i pozicionimit të listës së kandidatëve (pesë vendet e para rendore në lista)** dominohet nga kandidatët në grupmoshën 40-49 (n=119), pastaj në grupmoshat 50-59 (n=102) dhe 60-69 (n=75), ndërsa të paktën midis kandidatëve të rinj që i nënshtrohen analizës (për 18-29, n=34 dhe për 30-39, n=74), si dhe midis kandidatëve mbi moshën 80 (n=2).

Është e rëndësishme të theksohet se në grupmoshën e të rinjve 18-29 vjeç shumica e kandidatëve (n=88) janë pozicionuar në nivelin e fundit - të katërt (nga 16 në 20 vendin rendor në lista), ndërsa në grupmoshën e të rinjve 30-39 vjeç, kandidatët janë shpërndarë përafërsisht në mënyrë të barabartë në nivelet e tjera, më konkretisht në nivelin e dytë n=93, në nivelin e tretë n=94 dhe në nivelin e katërt n=90.


Grafiku 6 Shpërndarja e kandidatëve sipas grupmoshës dhe vendit rendor në listë (n)




Kur analizohet shpërndarja gjinore sipas grupmoshave dhe vendeve të kandidatëve në lista, mund të theksohet se në **nivelin "fitues" (pesë vendet e para në lista) më së shpeshti gjenden kandidatët dhe kandidatet nga grupmoshat 40-49 vjeç (burrat: 28,30%, gratë: 28,50%) dhe 50-59 (burrat: 23,60%, gratë: 25,70%).** Niveli i dytë (midis vendit të 6-të dhe të 10-të) më së shpeshti janë kandidatët nga grupmoshat 40-49 (26,70%) dhe 50-59 (25,70%) dhe kandidatet nga grupmoshat 30-39 (23,90%) dhe 40-49 (20,20%).

Informacion më i detajuar mbi shpërndarjen gjinore sipas grupmoshave për secilën nga katër nivelet e listave të kandidatëve tregohet në grafikët e mëposhtëm.


**Grafiku 7. Shpërndarja seksuale e kandidatëve të pozicionuar në nivelin e parë (renditja 1-5) sipas grupmoshave**




**Grafiku 8. Shpërndarja seksuale e kandidatëve të pozicionuar në nivelin e dytë (renditja 6-10) sipas grupmoshave**



**Grafiku 9. Shpërndarja seksuale e kandidatëve të pozicionuar në nivelin e parë (renditja 11-15) sipas grupmohave**




**Grafiku 10. Shpërndarja gjinore e kandidatëve të pozicionuar në nivelin e katërt (16-20) sipas grupmohave**



## Përshkrimi i mostrës së deputetëve të zgjedhur në përbërjen përbërëse të Kuvendit

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, mandatet parlamentare u fituan nga kandidatët e gjashtë subjekteve politike. Në grafikonin 11 jepet një pasqyrë e numrit të mandateve për secilin subjekt politik sipas njësive zgjedhore<sup>34</sup>. Qeveria (e përbërë nga Koalicioni "MAQEDONIA JOTE", Koalicioni VLEN dhe Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë) fitoi gjithsej 78 mandate, dhe opozita (KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE, Koalicioni "FRONTI EVROPIAN", Partia politike E majta) fitoi gjithsej 42 mandate.

Grafiku 11. Pasqyrë e numrit të mandateve parlamentare për secilin subjekt politik sipas njësive zgjedhore (n)




Dy të tretat e deputetëve të zgjedhur ose 66,7% janë të gjinisë mashkullore (n=80) dhe një e treta ose 33,3% të gjinisë femërore (n=40). Moshë mesatare në nivelin e deputetëve të zgjedhur është m=45,70 vjeç (SD=+/- 8,82, është në intervalin e moshës nga 27 deri në 65 vjeç). Kandidatët e rinj (18-29) përbëjnë vetëm 1,7% të deputetëve të zgjedhur (n=2), ndërsa, së bashku me kandidatët deri në moshën 39 vjeç, ata përbëjnë kumulativisht 23,4% (n=28) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Në vijim paraqitet shpërndarja e deputetëve të zgjedhur sipas grupmoshave.

34 iVote DEMOKRA - Sistemi i integruar i informacionit zgjedhor i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (sec.mk)

Grafiku 12. Shpërndarja e deputetëve të zgjedhur sipas grupmoshave




Krahasuar me tre përbërjet kuvendore të mëparshme, mund të vërehet se nuk ka ndryshime të rëndësishme për sa i përket moshës mesatare të deputetëve (~45), por ka dallime për sa i përket intervalit të moshës së deputetëve dhe përfaqësimit të tyre në secilën prej grupmoshave. Më konkretisht, për përbërjen kuvendore 2014–2016, moshë mesatare është 45 vjeç (me një interval të moshës midis 24 dhe 66 vjeç); për përbërjen kuvendore 2016–2020, moshë mesatare është 45,9 vjeç (me një interval të moshës midis 23 dhe 75 vjeç); për përbërjen kuvendore 2020–2024, moshë mesatare është 44,92 vjeç (me një interval midis 23 dhe 72 vjeç); për përbërjen kuvendore 2024–2028, moshë mesatare është 45,70 vjeç (me një interval të moshës midis 27 dhe 65 vjeç).

Shumica e deputetëve nga përbërja e fundit parlamentare (n=55) janë të moshës 40 deri 49 vjeç, që është përfaqësimi më i lartë i kësaj grupmoshe deri më tani. **Vërejmë një përfaqësim më të ulët të deputetëve të rinj të moshës deri në 29 vjeç, ndërsa rënia më e madhe është evidentuar në mesin e deputetëve të rinj nga grupmosha 30–39 vjeç (për çdo periudhë të mandatit të ardhshëm: n=34, n=33, n=34, n=26).**

Pasqyra krahasuese e shpërndarjes së deputetëve të zgjedhur sipas grupmoshave për të katër mandatet është dhënë më poshtë.

Grafiku 13. Shpërndarja e deputetëve të zgjedhur sipas grupmoshave për përbërjet kuvendore në periudhat 2014–2016, 2016–2020, 2020–2024 dhe 2024–2028 (n)






## Përshkrimi i përbërjes kuvendore drejtëpërdrejtë pas formimit të Qeverisë

Rezultatet e kësaj pjese u referohen deputetëve në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, drejtëpërdrejtë pas formimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>35</sup>. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se tetë deputetë - anëtarë të përbërjes konstitutive të Kuvendit pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2024, kaluan në pozita në pushtetin ekzekutiv, dhe në vend të tyre mandati i deputetit iu dha kandidatëve të vendeve të njëpasnjëshme në listat e vërtetuara<sup>36</sup>.

Pas ndryshimeve të tilla në përbërjen parlamentare menjëherë pas formimit të Qeverisë, ka pasur ndryshime të caktuara në karakteristikat demografike të deputetëve. **Krahasuar me përbërjen përbërëse, pas formimit të Qeverisë, në Kuvend ka pesë deputete më shumë, më konkretisht, 62,5% (n=75) deputetë janë të gjinisë mashkullore dhe 37,5% (n=45) janë të gjinisë femërore.** Një njohuri interesante është se kjo shpërndarje gjinore është identike me përbërjen parlamentare për periudhën e mandatit 2020–2024<sup>37</sup>. **Ka pasur një rënie të lehtë (-0,30) në moshën mesatare të deputetëve nga përbërja konstitutive, ndërsa intervali i moshës mbeti i njëjtë, m= 45,40 (SD=+/- 8,98, janë në interval të moshës nga 27 në 65 vjeç). Ka një rritje (+3) të numrit të deputetëve të rinj. Kandidatët e rinj (18–29) përbëjnë 2,5% të deputetëve të zgjedhur (n=3), ndërsa, së bashku me kandidatët deri në moshën 39 vjeç, ata përbëjnë kumulativisht një të katërtën ose 25,8% (n=31) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.** Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (menjëherë pas formimit të Qeverisë) sipas grupmoshave.

**Grafiku 14. Shpërndarja e deputetëve (menjëherë pas formimit të Qeverisë) sipas grupmoshave**



Krahasuar me tre përbërjet e mëparshme kuvendore, mund të vërehet se megjithëse ka devijime të vogla për sa i përket moshës mesatare të deputetëve, në të njëjtën kohë ka zhvendosje të konsiderueshme për sa i përket intervalit të moshës së deputetëve dhe përfaqësimit të tyre në secilën prej grupmoshave.

Më konkretisht, për përbërjen kuvendore 2014–2016, moshë mesatare është 45,02 vjeç (me një interval të moshës midis 23 dhe 66 vjeç); për përbërjen kuvendore 2016–2020, moshë mesatare është 46,10 vjeç (me një interval të moshës midis 23 dhe 75 vjeç); për përbërjen kuvendore 2020–2024, moshë mesatare është 44,82 vjeç (me një interval të moshës midis 23 dhe 72 vjeç); për përbërjen kuvendore 2024–2028, moshë mesatare është 45,40 vjeç (me një interval të moshës midis 27 dhe 65 vjeç).

**Megjithëse moshë mesatare ndryshon me vetëm +/- 1,28 me kalimin e viteve, diapazoni i moshës është më i vogli deri më tani.**

35 Megjithëse përbërja parlamentare mund të pësojë ndryshime shtesë, lista e të dhënave zyrtare për përbërjen e deputetëve menjëherë pas formimit të Qeverisë u shkarkua nga faqja e internetit e [Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut](#) më 2 korrik 2024. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Deputetët (sobranie.mk).

36 Deputetët janë Dragan Nedeljković, Velika Stojkova Serafimovska, Sergej Popov, Emilija Angelova, Vesna Gjorgjieva dhe Dijana Ilievska nga koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Feride Haxhiu dhe Kaltrina Haxhiu nga koalicioni Vlen. Ata erdhën në vendet e Hristijan Mickoskin (Kryeministër) dhe ministrit Gordana Dimitrieska Koçoska, Ljupčo Dimoski, Izet Mexhiti, Vlado Misajlovski, Ivan Stoilković, Aleksandar Nikoloski dhe Fatmir Limani.


37 Galevski, M., Gorgjiovska, J. (2020) MUNGESA POLITIKE RINORE: Analizë e pozitës së të rinjve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020. Botuesi: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Maqedonia e Veriut, në dispozicion në [Youth Political Absence - MK - web.pdf \(wfd.org\)](#)

Shumica e deputetëve nga përbërja e fundit parlamentare (n=51) janë të moshës 40 deri 49 vjeç, që është përfaqësimi më i lartë i kësaj grupmoshe deri më tani (edhe pse ky trend rritet vazhdimisht). **Vërejmë një përfaqësim më të ulët të deputetëve të rinj të moshës deri në 29 vjeç, ndërsa rënia më e madhe është evidentuar në mesin e deputetëve të rinj nga grupmosha 30-39 vjeç (për çdo periudhë të mandatit të ardhshëm në vazhdimësi: n=34, n=33, n=34, n=26).** Për krahasim, në përbërjen e mëparshme parlamentare 2020-2024, të rinjtë deri në moshën 39 vjeç përbënin një të tretën (32.5%) të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ndërsa në periudhën kohore 2024-2028, kandidatët deri në moshën 39 vjeç mbulojnë kumulativisht një të katërtën e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Të dhëna të tilla tregojnë një tendencë drejt përqendrimit të deputetëve në grupmoshën e mesme, gjë që sigurisht mund të ndikojë në vendimet dhe prioritetet politike. Diferenca më e vogël në moshë mund të kufizojë diversitetin e perspektivave dhe inovacioneve që deputetët mund të sjellin.

Pasqyra krahasuese e shpërndarjes së deputetëve të zgjedhur sipas grupmoshave për të katër mandatet është dhënë më poshtë.

**Grafiku 15. Shpërndarja e anëtarëve të Kuvendit menjëherë pas formimit të Geverisë sipas grupmoshave për secilin nga përbërjet kuvendore në periudhat 2014-2016, 2016-2020, 2020-2024 dhe 2024-2028.**



# ANALIZA E PËRFAQËSIMIT TË ÇËSHTJEVE RINORE NË PROGRAMET ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE DHE PROGRAMIT TË QEVERISË

## Përshkrimi i mostrës

Për këtë pjesë të Studimit, lëndë e analizës ishin gjithsej n=8 programe zgjedhore nga numri i përgjithshëm i subjekteve politike (n=17) që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2024<sup>38</sup>. Është e rëndësishme të përmendet se subjektet politike që janë pjesë e përbërjes së re të Kuvendit janë përfshirë në analizë, përmes programeve të tyre zgjedhore në dispozicion të publikut.

**Tabela 5.** Përshkrimi i mostrës: Pasqyra e programeve zgjedhore të analizuara sipas subjektit politik

SUBJEKTET POLITIKE	Programe zgjedhore të disponueshme – lëndë e analizës
AVAJA - MJAFT ËSHTË!	
GRUPI I VOTUESVE GJYLA ÇELIKU	
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë	✓
MAQEDONIA E VETME	
Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“	✓
Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“	✓
Koalicioni VLEN	✓
KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE	✓
Koalicioni GUXIMSHËM PËR MAQEDONINË	
Epoka e tretë maqedonase / Listat e pavarura maqedonase – Sovranët	
Partia politike DEMOKRATI Shkup	✓
Partia politike E DJATHHTA	✓
Partia politike E Majta	✓
Partia politike ALTERNATIVA E RE Shkup	
Partia politike MAQEDONIA VENDLINDJA	
Partia e punës	
PARTIA JOTE	

38 Dizajni i mostrës së kërkimit shpjegohet në detaje në kapitullin Metodologjia e kërkimit.

## Rezultatet e analizës

### Sa të rinj janë në fokus të programeve zgjedhore?

Përshtypja e përgjithshme është se të rinjtë janë në fokus, në shumicën e programeve zgjedhore që i nënshtrohen analizës (veçanërisht në programet e koalicionit).

Në programet e Koalicionit "MAQEDONIA JOTE", Koalicionit "FRONTI EVROPIAN", KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE, Koalicionit VLEN dhe Partisë politike E majta, të rinjtë paraqiten si një nga grupet kryesore të interesit të cilave ato u drejtohen.

Në programin e partisë politike E DJATHHTA, nuk u gjetën politika dhe masa që lidhen drejtpërdrejt me të rinjtë dhe studentët, dhe në programin e Lëvizjes ZNAM - Për Maqedoninë Tonë, të rinjtë përmenden vetëm një herë.

Për të përcaktuar më saktë përfaqësimin e të rinjve në programet zgjedhore, u realizua një analizë shtesë dhe sasiore, sipas së cilës subjektet politike ndahen në tre grupe, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes si më poshtë<sup>39</sup>:

- 1) grupi i parë – janë parashikuar 50 ose më shumë masa për të rinjtë, të mbuluara në më shumë se 10 fusha;
- 2) grupi i dytë – parashikohen 15 deri në 50 masa për të rinjtë, të mbuluara në 5 deri në 10 fusha;
- 3) parashikohen më pak se 15 masa për të rinjtë, të mbuluara në më pak se 5 fusha.

Koalicioni "MAQEDONIA JOTE" dhe KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE përmbushin kriteret për t'u renditur në grupin e parë.

Subjektet politike të mëposhtme i përkasin grupit të dytë: Koalicioni VLEN, E Majta dhe Koalicioni "FRONTI EVROPIAN", megjithëse janë regjistruar dallime brenda grupit në numrin e masave dhe fushave midis subjekteve.

Grupi i tretë përfshin: Lëvizjen ZNAM - Për Maqedoninë Tonë, Partia Politike DEMOKRATIKE Shkup dhe Partia politike E DJATHHTA.

Si implikim hulumtues, mund të vërehet se subjektet politike që fituan më shumë vende për deputet në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 i përkasin grupit të parë dhe të dytë.

**Tabela 6.** Përfaqësimi i masave për të rinj në programet zgjedhore të subjekteve politike

	Grupi i parë	Grupi i dytë	Grupi i tretë
Kriteret	50 ose më shumë masa për të rinj, të mbuluara në më shumë se 10 fusha	midis 15 dhe 50 masave për të rinj, të mbuluara në 5 deri në 10 fusha	më pak se 15 masa për të rinj, të mbuluara në më pak se 5 fusha
Subjektet politike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▲ Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“</li> <li>▲ KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▲ Koalicioni VLEN</li> <li>▲ E Majta</li> <li>▲ Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▲ Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë</li> <li>▲ Partia politike E DJATHHTA</li> <li>▲ Partia politike DEMOKRATI Shkup</li> </ul>
Gjithsej subjekte politike në grup	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

<sup>39</sup> Për tu kategorizuar në një grup, programet duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative të dy kriteret (numri i masave dhe numri i fushave).

## **Në cilat fusha tematike ka më shumë dhe në cilat më pak masa për të rinjtë?**

Sipas numrit dhe llojit të masave, fokusi i të rinjve është vendosur kryesisht në fushën e arsimit dhe shkencës, përmes masave të ndryshme për avancimin dhe përshtatjen e arsimit formal dhe joformal sipas kërkesave dhe tendencave të tregut të punës, përmirësimin e standardit të nxënësve/studentëve dhe mbajtjen e talenteve në arsim, shkencë, sektorin publik dhe real në shtet. E dyta për nga rëndësia janë masat ekonomike.

Pjesëmarrja e të rinjve, edhe pse nuk është një fushë prioritare, është në masë të caktuar e përfaqësuar në programe.

Ekziston vetëdija për rëndësinë e kulturës, si dhe aktivitetet sportive dhe rekreative për zhvillimin e përgjithshëm dhe psiko-fizik të të rinjve.

Janë përmendur një numër masash, të cilat pritet të përmirësojnë kushtet e fermerëve të rinj ose të inkurajojnë të rinjtë të angazhohen në bujqësi.

Lehtësimi dhe subvencionimi i banimit të të rinjve si masë sociale është pjesë e pjesës më të madhe të programeve zgjedhore.

Pandemia me Covid-19 dhe ndikimi i saj te të rinjtë është pjesë përbërëse e programit zgjedhor të Koalicionit FRONTI EVROPIAN, përmes një mase për të amortizuar vështirësitë në mësim.

Programet zgjedhore përmendin mbajtjen e të rinjve në vend, me masa më shpesh indirekte dhe të lidhura me arsimin cilësor, bursën dhe/ose punësimin e studentëve të talentuar. Në programin e Koalicionit "Maqedonia jote" ekziston një angazhim për të zhvilluar një strategji/plan për demografinë dhe krijimin e një Ministrie për politikë sociale, demografi dhe rini, e cila do të zvogëlonte emigrimin e të rinjve.

Vlen të përmendet se në programin e të Majtës, ka më shumë masa ndërsektorale për të rinjtë dhe studentët. Për shembull, parashikohen masa në fushën e arsimit dhe/ose ekonomisë, të cilat kanë si qëllim kryesor ofrimin e një zgjidhjeje për një problem specifik shoqëror ose ndihmën për një kategori të caktuar të të rinjve të pambrojtur nga shoqëria. Ekziston edhe një pjesë kushtuar të drejtave të studentëve në programin e Të Majtës.

Ekologjia dhe një mjedisi jetësor i shëndetshëm nuk janë fusha që lidhen me të rinjtë në programe, kështu që në përputhje me rrethanat, ka mungesë të masave të tilla.

Tabela e mëposhtme analizon fushat aktuale dominuese për të rinjtë në programet zgjedhore të subjekteve politike nga grupi i parë dhe i dytë, duke i dhënë përparësi fushave sipas numrit të masave të parashikuara në secilën prej tyre.

Analiza/tabela përjashton subjektet politike nga grupi i tretë, për shkak të numrit të vogël të masave të parashikuara për të rinjtë ose mungesës së tyre.

Ndarja e fushave tematike lind nga analiza diskursive dhe nga analiza e përmbajtjes së dokumenteve. Nga atje, ndahen fushat kryesore të mëposhtme:

- ▲ arsimi dhe shkenca;
- ▲ ekonomia;
- ▲ pjesëmarrja rinore;
- ▲ sporti;
- ▲ kultura;
- ▲ bujqësia dhe
- ▲ cilësia e jetës.

Tabela 7. Fushat prioritare për të rinjtë në programet zgjedhore të subjekteve politike

Subjektet politike	Prioriteti i parë	Prioriteti i dytë	Prioriteti i tretë	Prioriteti i katërt	Prioriteti i pestë
Koalicioni „MAQEDONIA JOTE“	Arsimi dhe shkenca;	Ekonomia	Cilësia e jetës	Pjesëmarrja rinore	Bujqësia
KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE	Arsimi dhe shkenca	Ekonomia	Cilësia e jetes	Pjesëmarrja rinore	Sporti
Koalicioni VLEN	Arsimi dhe shkenca	Ekonomia	Kultura	Sporti	Cilësia e jetës
Koalicioni „FRONTI EVROPIAN“	Ekonomia	Arsimi dhe shkenca	Pjesëmarrja rinore	Sporti	Cilësia e jetës
E Majta	Arsimi dhe shkenca	Cilësia e jetës	Kultura	Bujqësia	Ekonomia

Në pjesën e ardhshme vijon analiza të politikave dhe masave kryesore rinore që ofrojnë subjektet politike në secilën nga fushat e identifikuara.

## 1. Arsimi dhe shkenca

Kjo fushë është përparësia e parë në katër nga pesë programet zgjedhore të analizuar. Masat janë të gjera, konkrete, të matshme dhe të larmishme dhe për këtë arsye ndahen në disa nën-tema. Sigurisht, shumica e tyre i referohen promovimit të standardit të studentëve, si një koncept më i gjerë dhe integruar, dhe më pas përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe modernizimit të saj, zhvillimit dhe mbështetjes për studentët e talentuar, lëvizshmërisë arsimore ndërkombëtare, dhe të ngjashme.

### Standardi i nxënësve dhe studentëve

#### ▲ Arsimi i subvencionuar

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE”, KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE dhe partia politike E majta premtjnë studime falas në fusha të ndryshme shkencore dhe programe studimi, domethënë në profesione që konsiderohen tërheqëse ose të mangëta në vend. Për shembull, KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE angazhohet për studime falas për të gjithë studentët në Fakultetin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës, si dhe subvencione për studentët përmes kuponëve për participim (plani për zhvillimin e vazhdueshëm të veprimtarisë ndërtimore dhe zhvillimin e infrastrukturës së shtetit), pastaj dyfishimin e kuotave të Fakulteteve mjekësore, stomatologjike dhe farmaceutike, ku të gjithë studentët do të përjashtohen nga shpenzimet që do të paguheshin nga Qeveria nga Buxheti i MASH. Në program parashikohet edhe heqja e tatimit për paraqitjen e provimit E majta ofron futjen e arsimit të lartë falas, “d.m.th. arsimin e fakultetit të subvencionuar plotësisht publikisht, me heqjen e plotë të tarifave të participimit dhe tarifave të shkollimit për studentët”. Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” premtjon masa nxitëse për regjistrimin e studentëve në fakultetet e shkencave natyrore-matematike, teknike-teknologjike, bioteknike me përjashtim nga participimit dhe rritja e bursave mujore, si dhe bursa shtetërore për studentët më të mirë.

Sa i përket bursës studentore, KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE parashikon një rritje prej 40% të bursave studentore për studentët në fushën e shkencave bujqësore, pyjore dhe veterinarë në institucionet publike të arsimit të lartë në shumën prej 18.000 denarë në 25.000 denarë për një periudhë prej 9 muajsh të vitit, si dhe një bursë të veçantë për studentët më të mirë të gazetarisë, në nderim dhe kujtim të Nikolla Mladenov. Parashikohet dhënia e bursave për të rinjtë maqedonas që kanë lindur dhe jetojnë në rajon dhe diasporë, por duan të vazhdojnë arsimin e tyre në një nga universitetet maqedonase. Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” premtjon 50 milion euro për bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, duke rishikuar dhe ri-

prioritizuar programet ekzistuese dhe kriteret për dhënien e bursave në mënyrë që t'i marrin ato në bazë të rezultateve reale dhe nevojave reale; krijimin e një platforme digjitale për aplikimin për bursa; bursa të plota për të studiuar për profesione të mangëta dhe me rrogë të lartë; uljen e pjesëmarrjes me 50% për të gjithë nxënësit deri në 25 vjeç, të cilët janë prindër dhe bursa për nxënësit që do të arrijnë rezultate në olimpiadën botërore, një konkurs ndërkombëtar, kombëtar në njohuri në lëndë të ndryshme. Partia politike E Majta më tej angazhohet për rritjen e shumës së bursave studentore dhe ndryshimin e mënyrës së dhënies së bursave për studime pasuniversitare dhe doktorale jashtë vendit, ku ato do të jepen vetëm për fusha dhe specializime deficitare, të cilat nuk janë në universitetet e shtetit ose kandidatët që përsosën për vendin e punës, me detyrim për t'u kthyer në shtet. Më pas parashikohet prezantimi i kategorive të reja të bursave për nxënës dhe studentë të talentuar, si dhe mbështetje shtesë për të rinjtë që vijnë nga familje të varfra dhe me familje me rrezik social. Koalicioni VLEN në programin e tij kërkon të marrë mbështetje financiare për studentët cilësorë që do të regjistrohen në Fakultetin e pedagogjisë. Programi i Koalicionit "FRONTI EVROPIAN" ofron bursa për studentët më të mirë në vlerë prej 500 euro në muaj.

#### ▲ **Konviktet studentore**

Koalicioni "MAQEDONIA JOTE", KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE dhe partia politike E majta në programet e tyre angazhohen për përmirësimin e kushteve në konvikte studentore (në të cilat përveç studentëve mund të akomodohen edhe nxënës). KOALICIONI PËR NJË TË ARDHME EVROPIANE ofron gjithashtu një llogaritje të re të lartësisë të participimit që llogaritet për nxënës ose student dhe një rritje të vlerës të participimit nga Qeveria. Koalicioni "MAQEDONIA JOTE" i premton Qeverisë një investim prej 25 milionë eurosh të dedikuara për rinovimin dhe rindërtimin e plotë të konvikteve studentore. Partia politike E Majta parashikon rinovimin e të gjitha internateve dhe konvikteve studentore, si dhe ndërtimin e konvikteve të reja studentore – në Shtip dhe Shkup, me planifikim afatgjatë për ndërtimin e kampuseve plotësisht të integruara (të ashtuquajturat "qytete studentore").

#### ▲ **Racioni i subvencionuar**

Racioni i subvencionuar është i pranishëm në programet e Koalicionit "MAQEDONIA JOTE", KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE dhe partisë politike E majta. Në programin e Koalicionit "MAQEDONIA JOTE" parashikohet përmirësimi i Ligjit për racionin e studentëve, duke ndryshuar plotësisht zgjidhjen ekzistuese, duke rritur sasinë e racionit të studentëve dhe duke siguruar që mjetet e dedikuara për studentët do të përdoren. KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE premton të rrisë sasinë e racionit të studentëve në të paktën 200 denarë, si dhe një racion të subvencionuar për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme (180 denarë në ditë ose 900 denarë në javë). Programi i partisë politike E Majta parashikon një rritje të shumës së paguar për racionin e subvencionuar të nxënësve, pastaj ushqimin dhe racionin cilësor dhe falas në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, përmes futjes të mensave shkollore (pa koncesionarë privatë).

#### ▲ **Transport publik falas ose i subvencionuar**

KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE dhe partia politike E majta premtojnë transport publik pa pagesë (qytet dhe ndërqytet) për të gjithë nxënësit dhe studentët.

#### ▲ **Materialet arsimore dhe mjete ndihmëse mësimore/mësimdhënëse**

KOALICIONI PËR TË ARDHMEN EVROPIANE dhe partia politike E Majta premtojnë të subvencionojnë materialet shkollore dhe mjetet ndihmëse mësimore, respektivisht të sigurojnë tekste mësimore shkollore, doracakë dhe materiale pune cilësore dhe pa pagesë për çdo nxënës dhe mësimdhënës – në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe në fakultet.

#### ▲ **Bibliotekat dhe leximoret**

Koalicioni "MAQEDONIA JOTE" dhe Koalicioni "FRONTI EVROPIAN" parashikojnë futjen e e-bibliotekave në fakultete dhe digjitalizimin e materialeve mësimore. Partia politike E Majta angazhohet për punën e detyrueshme të pandërprerë në leximoret e universitetit dhe fakultetit – "non-stop", 24/7, si dhe furnizimin e rregullt me literaturë profesionale bashkëkohore (në formë të shtypur dhe elektronike).

## **Organizimi studentor**

Organizimi studentor është pjesë e programit të partisë politike E Majta, përmes masave të mëposhtme: ndihmë në hartimin e një sistemi të ri të përfaqësimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë; liberalizimi i së drejtës për formim më të lehtë të të ashtuquajturave klube studentore të sferave të ndryshme të interesit, për të cilat fakultetet do të duhet të japin hapësirat e duhura për përdorim të lirë.

## **Reformat në arsimin e mesëm dhe të lartë**

Vërehen masa që parashikojnë ndryshime të caktuara në sistemin arsimor. Në masë të madhe, ata janë të përfaqësuar në programin e partisë politike E majta: standarde më rigorozë dhe më të larta për akreditimin e institucioneve private të arsimit të lartë, me tendencë drejt ndalimit gradual të fakulteteve private, futjes së të ashtuquajturave lëndë të lidhura në të gjitha fakultetet; zvogëlimi i numrit të universiteteve shtetërore në katër (Shkup – UKM; Manastir – UKLO, Shtip - UGD dhe Tetovë – USHT); heqja e studimeve të shpërndara në të gjitha fakultetet; e drejta për studime të paguara postdiplomike dhe doktorale për të pasur vetëm studentë me një mesatare të lartë të studimeve universitare; rivendosja e provimeve pranuese në fakultete. Koalicioni VLEN parashikon: edukimin moral/etik dhe qytetar si lëndë e detyrueshme; unifikimin e sistemit dhe programeve mësimore me Shqipërinë dhe Kosovën; krijimin e gjimnazeve për teknologji dhe shkenca digjitale në Shkup, Tetovë dhe Manastir.

## **Cilësia dhe modernizimi i mësimdhënies**

KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE dhe Koalicioni “FRONTI EVROPIAN” premtojnë qasje të barabartë dhe arsim cilësor për të gjithë të rinjtë. Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” angazhohet për arsimimin digjital të të rinjve duke rritur fondin e orëve dhe pajisjet bashkëkohore në orët e teknologjisë së informacionit, si dhe duke mbështetur modernizimin e programeve studimore dhe metodave të mësimdhënies dhe të nxënit. Programi i Koalicionit “FRONTI EVROPIAN” përmban një masë për zhvillimin e aftësive organizative dhe frymës sipërmarrëse në arsim.

## **Praktika**

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” premtan të zhvillojë punën praktike të studentëve në kompani dhe institucione gjatë studimeve të tyre. Praktika është pjesë e programit të KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE, përmes një praktike të detyrueshme me pagesë për studentët nga Fakulteti i turizmit gjatë sezonit veror. Partia politike E Majta mbron të drejtën e praktikës së paguar të të gjithë studentëve në sektorin publik dhe privat.

## **Mbështetja dhe zhvillimi i talenteve**

Programi i Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” parashikon bashkëfinancimin e trajnimeve përmes një sistemi kuponash për studentët e talentuar, veçanërisht në profesione deficitare. KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE angazhohet për zhvillimin e zgjidhjeve sistemore për identifikimin dhe punën me nxënës të talentuar dhe me prirje në shkollat fillore dhe të mesme duke rishikuar programet e përshtatura për nxënës të talentuar.

## **Shkenca dhe inovacioni**

KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE premtan grante për hulumtimin dhe inovacionin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve. Partia politike E Majta premtan hapjen e stacioneve të hulumtimit shkencor për nxënësit e shkollave të mesme, nën kujdesin e universiteteve (si platformë për shkëmbimin dhe thellimin e njohurive të fituara).

## **Programe arsimore ndërkombëtare**

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” premtan të përforcojë programet për diplomë të dyfishtë në institucione të arsimit të lartë. Koalicioni VLEN parashikon që Qeveria të lidhë një marrëveshje me Kosovën dhe Shqipërinë, në mënyrë që studentët të kenë mundësinë të përfundojnë një vit akademik në një nga universitetet në ato vende.

## **Mbështetja e nxënësve dhe studentëve me aftësi të kufizuara**

Mbështetja për nxënësit me aftësi të kufizuara si masë përmendet vetëm në programin e KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE.



## **Udhëheqja në karrierë**

Udhëzimi ose udhëheqja në karrierë është pjesë e programeve të Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” dhe Koalicionit “FRONTI EVROPIAN”.

## **Mjedisi i sigurt arsimor**

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” parashikon zbatimin e programeve për parandalimin e dhunës në shkolla dhe për një mjedis të sigurt shkollor.

## **2. Ekonomia**

Në këtë fushë, subjektet politike kryesisht parashikojnë dhe premtojnë masa që do të përmirësonin gjendjen financiare të të rinjve, punësimin e të rinjve dhe ekonominë e biznesit në vend, përmes masave nxitëse dhe ndihmës para punësimit, lirimeve tatimore, programeve për rikualifikimin dhe kualifikimin shtesë të të rinjve të papunë dhe të rinjve NEET, mbështetje për fillimin e biznesit personal dhe të ngjashme.

### **Ndihma para punësimit**

**KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE në programin e tij premtom ndihmë financiare në lartësi prej 200 euro për punësimin e parë të të rinjve deri në 26 vjeç.** Për më tepër, ajo ofron një rritje të përfshirjes të Garancisë rinore, e cila do të mbulonte 35.000 persona. Për më tepër, është paraqitur një masë për të krijuar një mundësi për rikualifikimin e të rinjve me arsim të lartë që janë regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit (APRVM) për më shumë se 4 vjet. Programi i Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” gjithashtu përmban programet për punësimin e të rinjve dhe vetëpunësimin përmes Agjencisë së punësimit, me një buxhet prej 150 milionë eurosh, të cilat duhet të zhvillojnë aftësi dhe kualifikime për nevojat e tregut të punës. Koalicioni i FRONTIT EVROPIAN ofron masa mbështetëse për punësimin e të rinjve deri në moshën 29 vjeç, me mbështetje shtesë për punësimin e të rinjve që kanë qenë të papunë për më shumë se 24 muaj.

### **Lirimi nga tatimi**

Lirimi nga tatimi si masë ekonomike dhe stimuluese është përfshirë në programet zgjedhore. Në programet zgjedhore të koalicioneve “MAQEDONIA JOTE” dhe “FRONTI EVROPIAN”, planifikohen lirime nga tatimi mbi të ardhurat personale për të rinjtë e sapo punësuar deri në moshën 29 vjeç. Përfshirja nga tatimet për të rinjtë nën 30 vjeç, të cilët do të fillojnë një biznes në vend brenda një periudhe tre vjeçare, është një masë e Koalicionit VLEN. Ndërkohë, KOALICIONI PËR TË ARDHME EVROPIANE parashikon përfshirjen nga të gjitha detyrimet për punë sezonale dhe për punë me orar të shkurtuar të punës për studentët e punësuar deri në 2.500 euro në vit.

### **Masat ekonomike për grupet e cënueshme sociale dhe të marginalizuara**

Do të veçonim tre masa që kanë të bëjnë me të rinjtë nga grupet e cënueshme sociale ose të marginalizuara në programet e subjekteve politike. Më konkretisht, në programin E të Majtës parashikohet një program nacional “Punë për të gjithë” me masa për integrimin e të rinjve pa prindër dhe pa kujdes prindëror në procesin e punës. Programi i KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE parasheh rritjen e lartësisë së shtesës rinore dhe lëvizjen e kufirit për përfshirje në masë – rritjen e përfshirjes të të rinjve nga familjet e cënuara me përfshirje në punë dhe rritjen e lartësisë që ata marrin nga 3.000 denarë në 5.000 denarë në muaj, përmes ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për shtesat rinore. Nga ana tjetër, programi i Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” parashikon ndryshime ligjore me të cilat të rinjtë që janë përdorues të pensionit familjar mund të punësohen ligjërisht deri në gjashtë muaj gjatë vitit deri në moshën 26 vjeç, me kusht që të jenë studentë ose nxënës të rregullt.

### **Biznes-sipërmarrja**

Programi zgjedhor i Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” parashikon financimin e kompanive startup dhe iniciativave sipërmarrëse, me një buxhet prej 5 milionë eurosh. Koalicioni VLEN premtom një ekosistem mbështetës për sipërmarrësit e rinj përmes programeve nacionale financiare dhe programeve të mentorimit për digjitalizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në programin e Koalicionit “FRONTI EVROPIAN”, masat për sipërmarrësit e rinj parashikojnë mbështetje financiare për hapjen e një biznesi në zonat rurale dhe kredi me norma interesi të subvencionuara për kompanitë e sapokrijuara të të rinjve, të cilat synojnë “nxitjen e kulturës sipërmarrëse dhe ofrimin e mbështetjes konkrete për zhvillimin e bizneseve të tyre”.

## **Puna cilësore**

Programet zgjedhore të Koalicionit FRONTI EVROPIAN dhe KOALICIONIT PËR TË ARDHMEN EVROPIANE përshkruajnë angazhime për punë cilësore për të rinjtë, respektivisht punë cilësore në një treg konkurrues të punës (më pas).

### **Masat për frilenserë (profesionet e lira)**

Për të rregulluar statusin e punës së frilenserëve dhe sigurinë e tyre socio-ekonomike, ekzistojnë masa në programet zgjedhore të Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” – “paketë për frilenserë” dhe “E majta” – “krijimi i kushteve për sigurim shëndetësor dhe pensional për frilenserë të rinj deri në 26 vjet”.

### **‘Nomadët’ digjitalë**

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” propozon futjen e një vize të ripërtërishme për qëndrimin e nomadëve digjitalë, në mënyrë që të tërheqë profesionistë të rinj nga jashtë në vend.

### **Kalimi nga arsimit në punësim**

Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” premtan ofertë të garantuar pune për 500 studentët më të mirë me arritje më të larta akademike, përmes një programi të veçantë të Agjencisë së punësimin, si dhe punë honorare për studentët, domethënë mundësinë për të punuar me orar të shkurtuar të punës pa humbur statusin e studentit rregullt dhe mundësinë për të aplikuar për bursa. Në mënyrë të ngjashme, Koalicioni i FRONTIT EVROPIAN premtan të punësojë 200 studentët më të mirë në institucionet shkencore dhe publike. KOALICIONI PËR ARDHME EVROPIANE premtan punësimin e garantuar të të gjithë të diplomuarve në shkencat bujqësore, pyjore dhe veterinarë në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe mbajtjen e studentëve më të mirë duke i angazhuar ata në institucionet e arsimit të lartë dhe ato shkencore në vend ose në sektorin publik. Gjithashtu është planifikuar zhvillimi i softuerit “Puna rinore - E-youth job” (platformë elektronike që ndërmjetëson gjetjen e punës së përkohshme dhe punës me orar të shkurtuar të punës për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentëve). Partia politike E Majta premtan punësim të garantuar në shëndetin publik për studentët më të mirë të gjeneratës së fakulteteve mjekësore dhe subvencionim të drejtë financiar për mjekët e rinj në kujdesin shëndetësor parësor, me theks të veçantë për mjekët në fushat deficitare dhe zonat rurale.

## **3. Pjesëmarrja rinore**

Pjesëmarrja rinore përfaqësohet në masë të madhe në programin e Koalicionit “FRONTI EVROPIAN”, nëpërmjet masave të mëposhtme: përforsimi i ndikimit të të rinjve në procesin e vendimmarrjes, në nivel lokal dhe nacional; zbatimi i ligjeve dhe politikave për pjesëmarrjen e të rinjve, analiza periodike e efekteve të këtyre ligjeve, përshtatja dhe miratimi i akteve ligjore në bashkëpunim të ngushtë me të rinjtë, si dhe përfshirja e tyre në proceset konsultative për negociatat me Bashkimin Evropian; përforsimi i kapaciteteve institucionale, në kuptimin e përfshirja më e mirë e të rinjve në organet vendimmarrëse lokale dhe nacionale, si dhe avancimi i politikave rinore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrje në institucionet arsimore; përforsimi i aktivizmit rinor brenda hapësirës digjitale; përforsimi dhe qëndrueshmëria e kapaciteteve të sektorit të të rinjve si partner i institucioneve në krijimin e politikave për jetë më cilësore të të rinjve, duke analizuar programet dhe fondet lokale/nacionale për të siguruar përshtatshmërinë e tyre me nevojat aktuale të të rinjve për qëndrueshmëri dhe zhvillim të organizatave rinore; rregullimi dhe njohja e punës rinore nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të legjisllacionit përkatës.

Programi i Koalicionit “MAQEDONIA JOTE” parasheh themelimin e Qendrës për hulumtime mbi çështjet rinore, e cila, ndër të tjera, do të synojë të monitorojë zbatimin e planeve operacionale që do të dalin nga Strategjia nacionale (në kuadër të Ministrisë së re për politika sociale, demografi dhe të rinj, si dhe hapjen e qendrave rinore në disa qytete të vendit.

Në pjesën “Manifesti rinor” të programit të Koalicionit për të ARDHMEN EVROPIANE, ka disa përpjekje për të promovuar pjesëmarrjen rinore, por ato nuk paraqiten në formën e masave specifike.

## 4. Sporti

Shumica e masave në fushën e aktiviteteve sportive dhe rekreative në programet zgjedhore të subjekteve politike kanë të bëjnë në mënyrë indirekte me të rinjtë. Më shpesh, parashikohen investime në infrastrukturën sportive, transformim institucional dhe/ose riorganizim, dhe më pas financimi i aktiviteteve sportive, individëve dhe organizatave.

Për shembull, Koalicioni "MAQEDONIA JOTE" propozon transformimin e Agjencisë për rini dhe sport në Ministri të sportit, si dhe ndërtimin dhe rindërtimin e sallave sportive, qendrave sportive dhe rekreative dhe terreneve sportive në disa shkolla, në lagje të ndryshme në Shkup dhe në qytete të tjera.

Koalicioni për të ARDHME EVROPIANE parashikon masat e mëposhtme në programin e tij: një sistem sportiv të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm që do të kontribuojë në rininë dhe përmbajtjen e shëndetshme që do të motivojë të rinjtë; masivizimin e sportit dhe përmirësimin e rezultateve sportive për të gjitha sportet; të gjitha objektet sportive në pronësi të shtetit dhe komunave që janë dhënë me koncesion ose janë nën PPP do të duhet të sigurojnë 15% të orareve për fëmijët dhe të rinjtë nga kategoritë e cënueshme shoqërore; rindërtimin e sallave/terreneve sportive dhe ndërtimin e pishinave; ndërtimin e një qendre atletike dhe tenisi.

Programi i Koalicionit VLEN parashikon ndërtimin e 200 fushave të reja sportive në mandatin e parë dhe 200 të tjera në mandatin e dytë, si dhe mbështetjen për sportistët elitare dhe dhënien e rrogave shtetërore për atletët e shquar.

Partia politike E Majta ofron sponsorizim shtetëror të ligave sportive të nxënësve dhe studentëve.

Shumica e numrit dhe masave më specifike që lidhen drejtpërdrejt me sportin dhe të rinjtë dhe në të cilat përfaqësohet aspekti gjinor, përfaqësohen në programin e Koalicionit "FRONTI EVROPIAN": mbështetje për aktivitetet sportive të të rinjve - kuponë për sport të mbështetur nga buxheti dhe lehtësim nga taksat për të mbështetur sportet; ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve sportive si stadione, fusha sportive, salla sportive; promovimi i barazisë gjinore në sport, duke përfshirë mbështetjen e programeve dhe kampionateve respektivisht garave për vajzat dhe gratë, si dhe promovimi i trajnerëve të grave në sport; iniciativa për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në sport dhe për të ofruar më shumë mundësi për zhvillimin e aftësive sportive për të rinjtë në shkolla dhe qendra rinore.

## 5. Kultura

